



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

TESTI NGA MATEMATIKA

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <http://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numri e veçantë identifikues të nxënësit (shifra tetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 628202111344

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik, gomë, vizore, trekëndësh dhe kompas, por jo kalkulatorin.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet () , të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Te ato detyra tek të cilat ekzistojnë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrethë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR
Tek detyra me një përgjigje të saktë
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë. <input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevc
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta
Ngjyros rrethët para shprehjes, shumën e të cilës është 5. <input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5

- Nëse testin e përfundon para kohës së paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

TESTI NGA MATEMATIKA

1. Arbani duhet t'i dërgonte një letër shokut të vet Lirit. Mbushi formularin por nuk e dinte numrin postar të vendit ku banonte ai.

Pranoi: <i>Lir Asani</i>
Rruga: Nënë Tereza <u>10</u>
Numri Postar <u> </u> <u> </u> <u> </u> <u> </u> <u> </u>
Vendi: Gajdobra

Liri i kishte thënë se numri postar është njëzet e një mijë e katërqind e tridhjetë e dy.
Cili është numri postar i fshatit Gajdobre?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 21 032 21 432 21 002 21 402

2. Elvira në dyqan ka harxhuar 1000 dinarë për të blerë ëmbëlsira. Ajo bleu 2 çokollada, ndërsa me parat tjera bleu muffins. Nëse njëra çokolladë ka kushtuar 300 dinarë, ndërsa një muffins 20 dinarë, sa muffins ka blerë Elvira?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 10 20 30 35 40

3. Mjeshtri Afrimi dëshiron të llogrisë thellësinë e një pusi. Ai hodhi një gurë në pus dhe vëreu se guri ra poshtë për 3 sekonda (s). Për të llogaritur thellësinë përdori këtë formulë.

$h = 5t^2$ <p>h – Thellësia (m) t – Koha(s)</p>

Sa është i thellë pusi?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 30 m 45 m 75 m 150 m 225 m

4. Nëse $M = -4a$ dhe $T = -3a$, Llogarisni $M + T$ për secilin a ?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

$-7a$ $7a$ -7 $-a$

5. Në një pjesë të këndit të lojrave për fëmijë është vendosur një shtresë e rrumbullakët me rreze 5 m. Sa sipërfaqe ka kjo shtresë?


Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

5 m^2 10 m^2 25 m^2
 $5\pi \text{ m}^2$ $10\pi \text{ m}^2$ $25\pi \text{ m}^2$

6. Figura është ndërtuar nga kube të njejta, ku secili kub ka vëllimin 8 cm^3 .
Sa është vëllimi i figurës së dhënë?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

12 cm^3
 14 cm^3
 28 cm^3
 56 cm^3



7. Torta duhet të piqet për 1 orë e 25 minuta në temperaturë $200 \text{ }^\circ\text{C}$, pastaj 12 miunuta duhet të ftohet në frigorifer në temperaturë $6 \text{ }^\circ\text{C}$ përpara ngrënies. Sa minuta na duhen gjithësej për të përgaditur tortën?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

73 minuta
 85 minuta
 91 minuta
 97 minuta
 137 minuta
 238 minuta

8. Lumi i dërgoi shokut të vet një letër të koduar ku kishte shkruar një emër, të cilin mund ta lexonte vetëm me tabelën e dhënë.

5	A	B	E	J	K	M
4	H	O	P	J	C	B
3	B	A	J	K	K	C
2	T	M	M	O	E	K
1	J	B	H	P	M	O
	A	B	C	D	E	F


Deshifro letrën duke përdorur tabelën, nëse e di se shkronja T është në A2.

Emri në letër është

B2 A5 C3 F2

9. Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur të dhënat për numrin e nxënësve të regjistruar, në një shkollë të mesme të radhitur sipas drejtimeve dhe gjinisë. Sa nxënës janë regjistruar në gjimnazin e përgjithshëm? Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- 20
- 25
- 30
- 35
- 40
- 65
- 85



10. Sa është vlera e shprehjes $a - a \cdot \frac{1}{a}$ nëse $a = -\frac{1}{2} + 1$?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- =1 $-\frac{1}{2}$ $-\frac{1}{4}$ 0 $\frac{1}{4}$ $\frac{1}{2}$ 1


11. Ne figure është paraqitur plani i nje shtëpie

- 1 – Banja
- 2 – Kuzhina
- 3 – dhoma e ndejes
- 4 dhe 5 – dhoma e fjetjes
- 6 – Koridori.

Planifikohet të ndërrohet parketi në koridor, dhomen e ndejes dhe dhomat e fjetjes. Sa është sipërfaqja në të cilën duhet të ndërrohet parketi?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- 44 m²
- 48 m²
- 52 m²
- 54 m²
- 58 m²
- 60 m²
- 63 m²
- 66 m²
- 72 m²




12. Arbëri bleu një tokë në formë katrori me sipërfaqe 2 hektar (20 000 metra katëror). Si mund Arbëri të llogarisë gjatësinë e tokës në metra?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.


- Pjestonë 20 000 me 100.
- Pjestonë 20 000 me 4.
- Pjestonë 20 000 me 1 000.
- Shumëzon broj 2 me 1 000.
- Llogaritë katërorin e numrit 2.
- Llogaritë rrënjën katrore të 20 000.
- Llogaritë katërorin e numrit 20 000.
- Llogaritë sa ari ka në dy hektar.

- 13.** Ne grafik paraqitet lidhja e karburantit me rrugen e kaluar. Sa rrugë (km) ka kaluar makina nëse ka harxhuar 27 litra karburant?
Trego ecurin.



Makina kaloi _____ km.

- 14.** Mjeshtri duhet të ndërtojë një rrethojë me hekur sikur në figurën e dhënë.




Rrethoja përbëhet prej tri pjesëve drejtëkëndshe dhe diagonaleve të tyre. Sa dm hekur i duhen mjeshtrit për të ndërtuar këtë rrethojë?


Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 90 dm
- 108 dm
- 150 dm
- 198 dm
- 216 dm


15. Lira, Agoni dhe Arbani për detyrë shtëpie kanë pasur të vizatojnë figura të cilat kanë së paku dy simetri boshtore. Figurat e vizatuara janë paraqitur në figurë.



Lira



Agoni



Arbani


Ngjyros rrethin para emrit të nxënësit, i cili nuk e ka bërë figurën e saktë.

- Lira
- Agoni
- Arbani

16. Në një kompani e cila merret me paketimin e frutave, molla ndahet në tri kategori klasa 1, klasa 2 dhe ekstra klasa në bazë të kriterëve të dhëna në tabelë.

	Masa e mollave (m)
Klasa 2	$m < 0,15 \text{ kg}$
Klasa 1	$0,15 \text{ kg} \leq m < 0,2 \text{ kg}$
Ekstra klasa	$m \geq 0,2 \text{ kg}$

Ne foto janë paraqitur tri lloje të mollave.



150 g



105 g



115 g

Në cilën klasë futet secila nga këto molla?

Ngjyros rrethët të cilët lidhin mollët me klasën të cilës i takojnë.

	Klasa 2	Klasa 1	Ekstra Klasa
Molla A	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Molla B	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Molla C	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

- 17.** Njihësoni.
Tregoni ecurinë.


$$2,4 \cdot \left(\frac{1}{3} + 2 : 0,3 \right) - 0,6 \cdot \sqrt{1 + \frac{16}{9}} - \frac{4}{5}$$

Vlera është _____.

- 18.** Makina për shtyp për një orë shtyp 300 teste nga matematika. Secili test nga matematika përmban 3 fletë. Testi nga gjuha serbe përmban 4 fletë. Sa orë duhen për të shtypur 63 000 teste të gjuhës serbe në makinën e njejtë? Makina shtypë secilën fletë me shpejtësi të njejtë.
Tregoni ecurinë.

Duhet _____ orë.

- 19.** Në kubin me brinjë 4 cm është vendosur një piramidë në atë mënyrë që kulmet e bazës gjinden në mesin e brinjëve të kubit. Lartësia e të gjithë figurës është 10 cm. Llogaritni vëllimin e figurës.
Tregoni ecurinë.



$V = \underline{\hspace{2cm}} \text{ cm}^3$

- 20.** Libraria „Abetarja” gjatë javës së parë të qershorit ofron zbritje 15% për blerje online. Mimoza në këtë librari porositi një libër për të cilën me gjithë postë (350 dinarë), pagoi 1 115 dinarë. Sa ishte çmimi i librit pa zbritje?
Tregoni ecurinë.

Çmimi i librit ishte _____ dinarë.



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

TESTI NGA MATEMATIKA

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR